

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës

Ap.-Kz. Nr. 140/2011

Prishtinë

16 gusht 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën e kolegjit në përputhje me Nenin 26, par. (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe me Nenin 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 16 gusht 2011 në objektin e Gjykatës Supreme të Kosovës në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit dhe gjyqtarët e EULEX-it Francesco Florit e Martti Harsia, dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit,

Me procesmbajtësit Svetoslava Savova dhe Joseph Hollerhead ,

Në praninë e:

Prokurores publike ndërkombëtare Gabriele Walentich, nga Zyra e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës (ZPShK)

Avokatit mbrojtës Ljubomir Pantovic për të pandehurin Vukmir Cvetkovic,

Në lëndën penale AP-KŽ. Nr. 140/2011 kundër të pandehurve :

Vukmir CVETKOVIĆ, i lindur më 12 gusht 1969 in Pejë, emri i të atit _____, emri i së ëmës _____ me mbiemër të vajzërisë _____, serb i Kosovës, adresa e fundit: _____, Klinë, ish polic, i martuar, baba i një fëmije, me gjendje të dobët ekonomike, në paraburgim që nga data 10 mars 2009 (në Kosovë që nga data 13 korrik 2010), aktualisht i mbajtur në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë;

Në bazë të Aktgjykimit të shkallës së parë të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Pejë për lëndën P. Nr. 285/10, të datës 9 nëntor 2011, të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut të Pejës të njëjtën ditë, **i pandehuri është shpallur fajtor për këto vepra penale:**

[i] Më 27 dhe më 28 mars 1999, i pandehuri së bashku me një person tjetër, të dytë të veshur me uniforma dhe të armatosur, kanë detyruar me forcë S _____ dhe familjen e tij që ta lëshojnë shtëpinë e tyre në Klinë dhe të ikin për në Shqipëri;

[ii] Më 27 dhe më 28 mars 1999, i pandehuri duke pasur të veshur uniformën, ua ka vënë zjarrin së paku dy shtëpive në Klinë – dhe atë shtëpisë së N dhe shtëpisë së Z dhe K , duke përdorur flakëhedhësin.

Në këtë mënyrë, sipas Aktgjykimit të shkallës së parë, i pandehuri ka kryer veprën penale të Krimeve të luftës, në kundërshtim me Nenin 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), në kundërshtim me Nenin 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës, të datës 12 gusht 1949, dhe me Nenin 1 dhe 17 të Protokollit II të datës 8 qershor 1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949,

Dhe është dënuar:

Me shtatë vjet burgim, duke zbritur kohën e kaluar në arrest dhe në paraburgim.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit ka paraqitur ankesë më 25 shkurt 2011 kundër Aktgjykimit, i cili vlerësohej se përmbante shkelje esenciale të procedurës penale dhe vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe si pasojë e këtyre dy arsyeve të pohuara pohohej se edhe vendimi mbi dënimin dhe mbi shpenzimet e procedurës penale nuk do të ishte i drejtë.

Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar Z , Avokati Zeqir Berdyna nga Peja i është përgjigjur ankesës së Avokatit mbrojtës më 15 mars 2011 dhe ka propozuar refuzimin e ankesës si të pabazuar dhe konfirmimin e Aktgjykimit të shkallës së parë.

ZPShK-ja, në përgjigjen e saj të datës 3 qershor 2011 të regjistruar pranë Shkrimores së Gjykatës Supreme të Kosovës të njëjtën ditë, ka refuzuar ankesën pjesërisht me arsyetimin se është jomeritore dhe e pabazuar. Prokurori Publik ka ardhur në përfundimin që të miratojë pjesërisht ankesën dhe të ndryshojë dispozitivin e aktgjykimit të kontestuar.

- a) Duke ndryshuar emërtimin ligjor të veprës së kryer si vepër penale e “Krimeve të luftës kundër popullsisë civile”
- b) Duke sqaruar cilësimin përkatës të veprës penale sipas Nenit 142, par. 1 dhe 22 të KP të RSFJ-së, në kundërshtim me Nenin 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës, të datës 12 gusht 1949, dhe me Nenin 1 dhe 17 të Protokollit II të datës 8 qershor 1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949;

Por duke refuzuar kundërshtitë tjera të ngritura në pjesën tjetër të ankesës, duke përfshirë këtu edhe kërkesën për lirim të pandehurit.

Duke u bazuar në Aktgjykimin e shkruar në lëndën P. Nr. 285/10 të Gjykatës së Qarkut të Pejës, të datës 9 nëntor 2011 (të regjistruar në Shkrimoren e kësaj gjykate të njëjtën ditë), ankesa e dorëzuar me shkrim e Avokatit mbrojtës në emër të të pandehurit, deklaratat e Përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar dhe mendimi i ZPShK-së si dhe shënimet tjera përkatëse të kësaj lënde dhe deklaratat verbale të palëve gjatë seancës dëgjimore të datës

24 nëntor 2009, së bashku me analizën e ligjit të zbatueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit të mbajtur më datën 16 gusht 2011, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga Avokati mbrojtës Ljubomir Pantović në emër të të pandehurit miratohet pjesërisht ndërsa aktgjykimi i ankimuar ndryshohet me sa vijon:

Vepra penale e kryer nga i pandehuri cilësohet si Krime të luftës kundër popullsisë civile, sipas Nenit 142, par. 1 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së) dhe në kundërshtim me Nenin 3, të Konventës së katërt për të Gjenevës, të datës 12 gusht 1949, dhe me Nenet 1 dhe 17 të Protokollit të dytë plotësues të datës 8 qershor 1977, të Konventave të Gjenevës të vitit 1949

Lidhur me pjesët tjera, ankesa refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë vërtetohet.

ARSYETIM

Historia procedurale

1. Më 27 apo më 28 mars 1999, disa persona të gjithë të veshur me uniforma dhe të armatosur, kanë detyruar me forcë S dhe familjen e tij që ta lëshojnë shtëpinë e tyre në Klinë dhe të ikin për në Shqipëri. Përveç kësaj, një person duke pasur të veshur uniformën serbe, ua ka vënë zjarrin së paku dy shtëpive në Klinë – dhe atë shtëpisë së N dhe shtëpisë së Z dhe K, duke përdorur flakëhedhësin.

2. Dëshmitarët S dhe M si dhe E dhe P lajmëruan në Policinë e UNMIK-ut në vitin 2005 se në të dy rastet ishte i pandehuri Vukmir CVETKOVIC ai i cili personalisht kishte kryer veprat përkatëse penale. Dëshmitarët deklaruan se nuk kishin lajmëruar më herët, pasi që nuk e kishin parë më atypari deri më 2005 kur ata kuptuan se ai ishte kthyer në Klinë, kësaj radhe i veshur me uniformë të policisë së SHPK-së.

Aktvendimi mbi nisjen e hetimit ishte ushtruar nga Prokurori Publik më 17 shtator 2007 kundër Vukmir CVETKOVIC dhe ishte vazhduar deri më 17 shtator 2008.

Më 04 korrik 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë lëshoi një Urdhër Arrest kundër të pandehurit.

Më 08 korrik 2008 Zyra e Prokurorit Publik Ndërkombëtar njoftoi Gjykatën e Qarkut në Pejë se Vukmir CVETKOVIC ishte gjetur në Norvegji. Prandaj, më 15 korrik 2008, Gjykata e lartpërmendur lëshoi një letër-rreshtim vendor kundër tij, dhe iu drejtua organeve kompetente me kërkesë për lëshimin e një letër-rreshtimi ndërkombëtar.

Më 21 korrik 2008, pasi që i pandehuri ishte në arrati, Prokurori Publik vendosi ti pezullojë hetimet.

Më 26 nëntor 2008, ishte lëshuar një letër-rreshtim ndërkombëtar dhe Interpoli shpërndau një letër-rreshtim të kuq.

Më 13 korrik 2010, Vukmir CVETKOVIC u ekstradua në Kosovë dhe u arrestua. Shqyrtimi mbi paraburgimin u mbajt në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 14 korrik 2010. Gjykata vendosi për një muaj paraburgim, që u vazhdua nga kolegji prej tre gjyqtarëve më 12 gusht 2010 deri më 13 tetor 2010.

Zyra e Prokurorit Special të Kosovës (PSRK) ngriti një Aktakuzë më 08 shtator 2010, duke akuzuar Vukmir CVETKOVIC për Krime Luftë kundër Popullatës Civile në kundërshtim me Nenet 22 dhe 142 të KP RSFJ-së dhe kërkoi që paraburgimi t'i vazhdohet. Prandaj, në përputhje me Nenin 360 paragrafin 5 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) kolegji prej tre gjyqtarëve me vendimin e datës 19 shtator 2010 vazhdoi paraburgimin deri më 10 nëntor 2010.

Më 21 shtator 2010, u mbajt një seancë për konfirmim të aktakuzës në prani të të pandehurit, Avokatit të tij mbrojtës dhe Prokurorit Publik. Gjyqtari për konfirmim vendosi se Aktakuza ishte në pajtueshmëri me kushtet ligjore dhe prandaj u konfirmua .

Më 26 tetor 2010, u hap Shqyrtimi gjyqësor dhe vazhdoi në katër seanca më 26, 27, dhe 28 tetor dhe 09 nëntor 2010, kur u shpall Aktgjykimi. Përveç inspektimit të vendit të ngjarjes më 28 tetor 2010, për të cilën ai kishte hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë, i pandehuri vazhdimisht ishte i pranishëm. Avokati mbrojtës i të pandehurit, Prokurori Publik i EULEX-it, palët e dëmtuara M , S , Z dhe K si dhe Përfaqësuesit ligjorë të palës së dëmtuar Z ishin të pranishëm në të gjitha seancat.

Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit gjyqësor dëgjoi dëshmitarët M (më 26 tetor 2010 dhe gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 28 tetor 2010), S (më 26 tetor 2010), E (më 27 tetor 2010 dhe gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 28 tetor 2010) dhe P (më 27 tetor 2010 dhe gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 28 tetor 2010). Përveç kësaj, raportet policore si dhe fotografitë e shtëpive të djegura përkatëse dhe dyerve të mullirit të fotografuara nga Prokurori Publik dhe të siguruara nga pala e dëmtuar Z dhe K gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes më 28 tetor 2010 dhe dëshmia e të pandehurit e dhënë në PSRK më 17 gusht 2010 janë lexuar gjatë seancave të gjyqimit apo janë konsideruar të lexohen.

11. Duke u bazuar në gjetjet e veta, Gjykata e Qarkut në Pejë më 08 mars 2007, shpalli Aktgjykimin dhe shpalli të akuzuarin fajtor për veprat penale të shënuara më lart nga pikat [i] deri [ii]. Rrjedhimisht, Gjykata ndaj të akuzuarit shqiptoi dënimet e specifikuar më lart.

12. **Avokati mbrojtës** i të akuzuarit paraqiti ankesë brenda fatit ligjor më 25 shkurt 2011 kundër Aktgjykimit të përmendur më parë.

Po ashtu **Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar Z** , iu përgjigj ankesës së Avokatit mbrojtës më 15 mars 2011 siç u përmend më herët..

ZPShK-ja paraqiti një mendim më datë 03 qershor 2011 dhe e regjistroi atë në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën ditë, po ashtu siç u përmend më herët.

13. Më 09 gusht 2011, Gjykata Supreme e Kosovës mbajti një seancë në përputhje me Nenin 410 të KPPK-së.

Avokati mbrojtës konfirmoi parashtresat dhe kërkesën e tij.

ZPShK-ja arriti në përfundim të pranohet pjesërisht ankesa dhe të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar siç u theksua në mendimin me shkrim të datës 3 qershor 2011.

GJETJET E GJYKATËS

A. Shkeljet esenciale të dispozitave të Procedurës Penale

I. Mospërputhshmëria e pretenduar e dispozitivit

14. Avokati mbrojtës në ankesën e tij si dhe ZPShK-ja në mendimin ligjor të tyre të dytë **pretendojnë në shkelje të Nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së** për shkak të dispozitivit të Aktgjykimit të kundërshtuar i cili nuk përshkruan plotësisht dhe drejt emërtimin juridik të veprës penale të Nenit 142 të KP RSFJ-së si “Krime të luftës kundër popullatës civile”, por vetëm si “Krime të luftës” si dhe nuk i referohet paragrafit të veçantë të Nenit 142 të KP RSFJ-së.

15. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar nuk është në përputhshmëri me ligjin dhe prandaj shkel Nenin 403 paragrafin 1 pikën 12 të KPPK-së.

Edhe pse është përtej të gjitha dyshimeve të arsyeshme se Gjykata e shkallës së parë flet për veprën penale nën Nenin 142 të KP RSFJ-së dhe në veçanti duke marrë parasysh emërtimin e drejtë juridik të veprës përkatëse penale nën Nenin 142 të KP RSFJ-së, që është emërtuar sipas Aktakuzës së referuar të datës 08 shtator 2010 (PPS 18/09) si “Krime të luftës kundër popullatës civile”, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se vërtetë

Gjykata e Qarkut nuk ka arritur ta përdorë emërtimin e plotë të Nenit 142 të KP RSFJ-së si “Krime të luftës kundër popullatës civile” dhe flet vetëm për “Krime të luftës”.

Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se Gjykata e shkallës së parë nuk arrin ti referohet paragrafit të veçantë të Nenit 142 të KP RSFJ-së, prandaj krijon hutim se cila vepër penale nga tri llojet e ndryshme të përshkruara me dispozitat përkatëse ligjore është dhënë në këtë lëndë.

Neni 142 i KP RSFJ-së në botimin e pestë të vitit 1995 përcakton si në vijim:

(1) Personi i cili, në shkelje të rregulloreve të ligjit ndërkombëtar gjatë luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit, jep urdhër të kryhet sulm kundër popullatës civile, vendbanimit, individëve civilë të paaftë për luftë, që për pasojë kishin vdekje, lëndim të rëndë fizik ose çrregullime të rënda të shëndetit të njerëzve; sulm pa zgjedhur cakun duke e qëlluar popullatën civile; vrasja, torturimi, trajtimi jonjerëzor, eksperimentim mjekësor biologjik ose shkencor tjetër, marrja e indeve apo organeve për transplantim, shkaktim i vuajtjeve të mëdha apo cenim i integritetit fizik ose i shëndetit; zhvendosje ose rikolonizim ose përjashtim me forcë nga vendi ose kthim në fe tjetër; detyrim në prostitucion ose dhunim; aplikim të masave të frikësimit apo terrorit, marrja peng, dënim kolektiv, dërgim i dhunshëm në kampe të përqendrimit dhe burgim tjetër të paligjshëm, privim nga e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; shërbim të detyruar në forca të armatosura të armikut ose në shërbim të inteligjencës apo administratës së armikut; punë të detyruar fizike, mosushqimi i popullatës, konfiskimi i pronës, grabitja e pronës së popullatës, shkatërrim joligjor dhe i vullnetshëm ose marrja në posedim e pronës në shkallë të lartë, e cila nuk arsyetohet me nevojat e ushtrisë, marrja joligjore dhe jo-proporcionale e kontributeve të mëdha dhe pasurive, zhvleftësimi i vlerës së parasë vendore, të cilat kryen kundër popullatës civile ose personi i cili kryen disa nga aktet e përmendura do të dënohet me së paku pesë vite burgim ose njëzet vite burgim.

(2) Kushdo që duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur ose të okupacionit urdhëron që: të zhvillohen sulme kundër objekteve posaçërisht të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare dhe objekteve dhe strukturave, me forcë të rrezikshme, si pendat, digat, centralet bërthamore; pa zgjedhjen e caktuar, objekteve civile nën mbrojtjen speciale të së drejtës ndërkombëtare, vendet e pambrojtura dhe zonat e demilitarizuara; dëme afatgjate dhe në shkallë të madhe të ambientit natyror i cili mund ta dëmtoj shëndetin ose mbijetesën e popullatës, ose pesoni i cili kryen disa nga aktet e përmendura, do të dënohet me dënim nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Kushdo që duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur ose të okupacionit urdhëron ose kryen zhvendosjen e një pjese të popullatës së tij/saj në territorin e okupuar, do të dënohet me së paku pesë vite burgim.

Duhet të lihet e hapur, nëse gjykata e shkallës së parë ka qenë në dijeni të versionit të fundit të nenit 142 të KP RSFJ-së, ose jo, siç është cituar më parë, dhe nga neglizhenca

nuk i është referuar në mënyrë të drejtë paragrafit specifik të ligjit, ose nëse gjykata ka aplikuar në mënyrë të gabuar versionin e vjetër të nenit 142 të KP RSFJ-së të datës 1 korrik 1977, e që ky i fundit ofron vetëm një paragraf.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se akuzat kundër të pandehurit mund të përfshihen vetëm nën nenin 142 paragrafin 1 të KP të RSFJS-së të botimit të 5-të, të vitit 1995, si që kryerja e “*zhvendosjes ose rivendosjes ose tërheqja e dhunshme*” dhe “*vjedhja e pronës ose pupollatës*” e drejtuar kundër pupollatës civile.

Pasi që nenit 142 i KP RSFJ-së në versionit e tij më të vjetër të datës 1 korrik 1977, është pothuajse identik me nenin 142 paragrafin e KP RSFJ-së të datës 1995, nuk e bën të domosdoshme që të vendoset lidhur me cilësinë e gabimit të bërë nga Gjykata e Qarkut, siç është theksuar më herët.

II. Mospërputhja e pretenduar e arsytimit të aktgjykimit të kundërshtuar në lidhje me faktet vendimtare:

Për më tepër, avokati mbrojtës ka kundërshtuar se i tërë aktgjykimi i shkallës së parë është bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve të cilët janë ftuar nga Prokurori Publik dhe pa i marrë parasysh faktet se ka pasur dallime në dëshmitë e dëshmitarëve S , M , E dhe P në krahasim me dëshmitë e tyre të mëhershme si dhe në krahasim të ndërsjellë me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë. Në veçanti, gjykata e shkallës së parë nuk ka theksuar dallimet në detaje dhe në këtë mënyrë nuk ka vlerësuar drejtë provat e dhëna. Prandaj, arsytimi i aktgjykimit të kundërshtuar është tërësisht i paqartë dhe në mospërputhje në lidhje me faktet vendimtare.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se nuk mund të vërtetohet asnjë mospërputhje e arsytimit në lidhje me aktgjykimin e kundërshtuar.

Pas kontrollimit të gjitha dëshmive të referuara të dëshmitarëve në shkresat e lëndës, në të vërtetë janë vërtetuar disa mospërputhje në mes të dëshmive të dëshmitarëve të njëjtë të dhëna në raste të ndryshme. Kjo në mes tjerash i referohet uniformës së pretenduar të bartur nga i pandehuri Vukomir Cvetkovic më 27/28 mars 1999, gjatë veprimeve diskutabile.

Sidoqoftë, prej faqes 5 deri në faen 7 dhe prej faqes 7 deri në 12 të aktgjykimit të kundërshtuar bëhet e ditur se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar dhe analizuar në mënyrë të hollësishme të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve dhe në veçanti i ka kushtuar vëmendje të madhe çështjes së besueshmërisë së dëshmitarëve S , M , P dhe E si dhe kredibilitetit të dëshmive të tyre. Në lidhje me dëshmitarin S , gjykata e shkallës së parë ka nënvizuar njohurinë e kolegjit në lidhje me mangësitë në mes të dëshmive të dëshmitarit të dhëna para gjykatës dhe dëshmive të tij të mëparshme. Megjithatë, gjykata ka gjetur se “[ë]shtë çështje e logjikës së shëndoshë se kapaciteti i mbajtjes në mend në përgjithësi zvogëlohet dhe me elementet e intervistave në veçanti ato të rëndësisë së

vogël ndryshojnë sa më shumë që dëshmitari merret në pyetje lidhur me temën e njëjtë” ... [dhe se] ... “do të duhej të ishte e kuptueshme për të gjithë se normalisht një dëshmitar do të ketë më pak njohuri për detajet pas një periudhe dhjetë vjeçare, periudha e cila ka kaluar që nga koha e veprës”. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se gjithashtu “është logjikë e shëndoshë se në përgjithësi ato dëshmi të cilat janë paraqitur më së herti pas kryerjes së krimit mund të konsiderohen si më të besueshmet, sepse atëherë memorja e dëshmitarit është më e freskët” dhe se në lidhje me këtë do të fliste “në dobi të besueshmërisë së dëshmitarit që ai tani [kishte] inkriminuar të akuzuarin në mënyrë të lehtë” sesa gjatë dëshmisë së tij të mëparshme (faqe 8 e versionit në gjuhën angleze).

Në lidhje me dëshmitarët M , P dhe E , gjykata e shkallës së parë ka bërë referim të qartë në gjetjet dhe vlerësimin e saj lidhur me dëshmitarin S dhe dëshmive të tij (faqet 10 deri në 12 të versionit në gjuhën angleze).

Aktgjykimi i kundërshtuar gjithashtu i është referuar faktit pse dëshmitarët e kanë njoftuar policinë vetëm në vitin 2005, disa vite pasi që kanë ndodhur krimet (faqe 9 e versionit në gjuhën angleze).

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban arsyetim mopërputhës në bazë të vlerësimit të dobët ose të gabuar të provave.

Gjykata Supreme e Kosovës në kontekstin e dhënë i referohet gjykimit të saj në veçanti në lëndën *Runjeva, Axgami dhe Dema* (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05, të datës 25 janar 2008, faqe 20), ku është theksuar se “procedura ankimore në KPPK mbështetet në parimet që trupi gjykues i dëgjon, vlerëson dhe peshon provat në gjykim [...]. Prandaj, gjykata e apelit duhet t’i jap trupit gjykues hapësirë veprimi për gjetjet e saj faktike. Nuk duhet t’i trazoj gjetjet e trupit gjykues për t’i zëvendësuar me të vetat, përveç nëse provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues nuk do të ishin pranura nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktorit ku vlerësimi i saj ka qenë ‘tërësisht i gabuar’ ”. Ky aktgjykim është përsëritur në mes tjerash në lëndën kundër Jeton Kiqinës (Ap.-Kž. Nr. 84/2009), të datës 3 dhjetor 2009, (faqe 19 e versionit në gjuhën angleze, pika 35). Nuk është as në kompetenca të kolegjit ankimor e as nuk është e mundshme që të zëvendësohen të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë me të vetat, posaqërisht pa i marrë të gjitha provat përsëri.

B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

33. Avokati mbrojtës në ankesën e tij pretendon në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të krimit, duke pohuar se dëshmitarët M , S , E dhe P , vetëm mbi dëshmitë e të cilëve i pandehuri është shpallë fajtor, janë tërësisht jobindës dhe kontradiktorë në dëshmitë e tyre. Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 3 paragrafin 2 të KPPK-së, sipas të cilit fajësia e të pandehurit duhet patjetër të dëshmohet përtej çdo dyshimi.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se nuk mund të konstatohet vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike në lëndën në fjalë, të paktën jo deri në atë masë e cila do të shpie në anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar.

Duhet të theksohet se në lëndën në fjalë në të vërtetë duhet patjetër të konstatohen disa mospërputhje në mes të disa dëshmive të dëshmitarëve të përmendur siç janë cekur më parë. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se sipas të gjitha dëshmive të dëshmitarëve në shkresat e lëndës, i pandehuri Vukmir CVETKOVIC është identifikuar në mënyrë të qartë si njëri prej kryerësve i cili ka dëbuar familjet e dëshmitarëve nga shtëpitë e tyre dhe vënien e zjarrit të shtëpive të N dhe Z K duke e përdorur flakëhedhës.

Dëshmitari M më 24 shtator 2005 ka deklaruar para Policisë së UNMIK-ut se ka parë Vukmir CVETKOVIC duke ia vënë zjarrin shtëpisë së N dhe se ai ishte i shoqëruar nga Mi dhe B, V dhe familja X. Dëshmitari faktikisht ka përsëritur përmbajtjen e dëshmisë së tij gjatë marrjes në pyetje në polici më 16 dhjetor 2007, dhe e ka specifikuar atë me rastin e marrjes tjetër në pyetje më 16 shkurt 2007, kur ka theksuar se ai kishte parë të pandehurin duke e djegur shtëpinë e N me flakëhedhës dhe ishte në shoqërinë e Mi dhe B dhe se gjithashtu shtëpia e dëshmitarit ishte djegur tërësisht, mirëpo që ai, dëshmitari, nuk i ka parë kryerësit. Edhe pse dëshmitari më 9 maj 2008, ka deklaruar se nuk ishte i pandehuri ai i cili e kishte dëbuar atë dhe familjen e tij nga shtëpia, ai prapë ka përsëritur se e kishte parë të pandehurin duke i djegur shtëpitë e N dhe Z me flakëhedhës, dhe se ai, dëshmitari në atë kohë ishte i ulur në traktor dhe në proces të largimit të dhunshëm nga Klina. Dëshmitari ka përsëritur dëshminë e tij përkatëse më 9 gusht 2010, para Prokurorit dhe përfundimisht para Gjykatës së Qarkut më 26 dhe 28 tetor 2010.

Dëshmitari S ka dëshmuar më 24 shtator 2005, para Policisë së UNMIK-ut se i pandehuri ishte njëri prej atyre i cili kishte djegur tërë lagjen e dëshmitarit në Klinë dhe që përveç kësaj ai ishte njëri prej atyre që ka dëbuar Shqiptarët nga shtëpitë e tyre, me atë rast ka pasur një armë automatike Kallashnikov (AK 47) me vete. Ai e ka përsëritur deklaratën e tij më 27 nëntor 2006 në Polici dhe në pjesë më 08 shtator 2010 para Prokurorit, duke deklaruar atë kohë se i pandehuri, që mbante një Kallashnikov, ishte njëri nga ata që dëbonte Shqiptarët nga shtëpitë e tyre, por që ishte një person tjetër i cili i kërkoi dëshmitarit të lëshonte shtëpinë e tij. E fundit është përsëritur prapë në Gjykatën e Qarkut më 26 tetor 2010.

Dëshmitari P ka deklaruar më 07 mars 2008 në Polici si edhe më 27 dhe 28 tetor 2010 në Gjykatën e Qarkut se ai ka parë të pandehurin së bashku me dy të tjerë, i cili këta të fundit më 27 tetor 2010 i quajti si Mi dhe B, të cilët kanë djegur shtëpinë e N me përdorimin e flakë hedhësit.

Dëshmitari E ka deklaruar më 24 shtator 2005 se ishte i pandehuri bashkë me Mi dhe B të cilët erdhën në shtëpinë e dëshmitarëve dhe u

kërkuan të shkonin në Shqipëri. Më 16 dhjetor 2006 dëshmitari ka deklaruar se i pandehuri dhe dy shoqëruesit e tij përkatës kanë djegur shtëpinë e Z , duke përdorur flakë hedhës. Dëshmitari ka konfirmuar këtë deklaratë më u 16 shkurt 2007, më 12 maj 2008 dhe në Gjykatën e Qarkut më 27 tetor 2010.

Dallimet kryesore / mospërputhjet në lidhje me dëshmitarët përkatëse dhe deklaratave të tyre mund të vërtetohen sa i përket uniformës që i pandehuri supozohet ta kishte veshur më 27/28 mars 1999 dhe në lidhje me pyetjen, nëse ishte apo jo i pandehuri ai që dëbonte dëshmitarin S dhe familjen e tij nga shtëpia e tyre.

Në të vërtetë në lidhje me këtë mund të kritikohet se gjykata e shkallës së parë nuk i ka renditur dhe analizuar të gjitha mospërputhjet në mes të deklaratave të ndryshme. Megjithatë, dy pika duhet theksuar qartë, që nga fillimi ekziston një ‘vijë e kuqe’ në të gjitha deklaratat të cilat konfirmojnë se i pandehuri kishte një rol udhëheqës kur janë djegur shtëpitë e N dhe të Z dhe K , dhe se të paktën është një tregues i fortë për pretendimet që i pandehuri ka marrë pjesë edhe në dëbimin e dëshmitarëve nga shtëpitë e tyre.

Në veçanti, referenca është bërë me atë që tashmë është theksuar nën pikën A. II , f. 12 të këtij aktgjykimi në lidhje me vlerësimin e provave të kryera nga gjykata e shkallës së parë dhe në lidhje me domosdoshmërinë e Gjykatës Supreme për tu mbështetur në këtë vlerësim për aq sa vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ‘tërësisht i gabuar’.

C. Vendimi mbi dënimin

52. Për më tepër mbrojtja pretendon se si rezultat i një shkelje esenciale të pretenduar të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe vendimi për dënimin duhet të rishikohet.

Vendimi për dënimin është i drejtë. Gjykata e shkallës së parë në përputhje me kuadrin e dënimeve të mundshme të dhënë nga ligji përkatës (neni 142 paragrafi 1 i KP të RSFJ-së), ka shqiptuar dënimin prej shtatë (7) vjet për dy pikat e aktakuzës për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor. Në favor të të pandehurit është peshuar në veçanti fakti se ai nuk ishte i dënuar më parë, se ai është mirë i arsimuar dhe social, i martuar, baba i një fëmije të mitur, se periudhë e gjatë kohore ka kaluar që nga atëherë kur krimet janë kryer dhe se krimet në krahasim me të tjerat të kryera në periudhën përkatëse janë të një karakteri mesatare. Në dëm të të pandehurit u konsiderua ajo që i pandehuri nuk ka kryer vetëm një, por dy raste të ndryshme të krimeve të luftës, që ai i ka vënë zjarrin jo një por dy shtëpive dhe se në këtë mënyrë ai ka rrezikuar seriozisht shtëpitë fqinje, si edhe jetën e popullatës që ka jetuar përreth.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë saktë dhe tërësisht ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në ashpërsinë e ndëshkimit dhe ka vlerësuar në mënyrë të drejtë ato rrethana. Prandaj, nuk mund të shihet arsye për të zvogëluar dënimin. Në mënyrë të veçantë duke pasur parasysh faktin se në kundërshtim me mendimin e mbrojtjes, nuk është vërtetuar mospërputhje e arsytimit të aktgjykimit të

kundërshtuar dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të fakteve, nuk ka asnjë arsye për të ri-shqyrtuar dënimin të shpallur nën këto rrethana.

D. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

53. Në ankesën e tij, avokati mbrojtës ka propozuar të ri-vlerësohet vendimi i shkallës së parë në lidhje me shpenzimet e procedurës penale, me të cilën i pandehuri është ngarkuar.

Adresimi është bërë në atë çfarë është thënë më herët (*pika C. f.11 e këtij aktgjykimi*). Vendimi mbi koston e procedurës pason fajësinë e të pandehurit sikurse përshtatshëm është shpallur sipas nenit 102 paragrafi 1 i KPPK.

Për arsyet e lartë përmendura Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv.

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kž. Nr. 140/2011
16 gusht 2011
Prishtinë

Anëtarët e Kolegjit:

Francesco Florit
Gjyqtar i EULEX-it

Martti Harsia
Gjyqtar i EULEX-it

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Kryetar i Kolegjit:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

